



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 119

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 12 korrik 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 10.7.2024	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Roskovec, të pasurive me numër 213/1-ND1, 213/1-ND2 dhe 213/1-ND3, zona kadastrale 3805, Njësia Administrative Kurjan, si dhe për disa shtesa në vendimin nr. 770, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.....	14335
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 454, datë 10.7.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtimi i Kopshtit nr. 37”, Bashkia Tiranë.....	14340
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 455, datë 10.7.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr. 3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)”, Bashkia Roskovec.....	14342
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 10.7.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 101, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kohën e punës dhe të pushimit në Policinë e Shtetit”	14344
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 10.7.2024	Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit, organizimit, klasifikimit dhe tarifave të regjistrimit të veprave të të drejtave të autorit.....	14344
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim nr. 825/6, datë 9.7.2024	Për shpronësimin për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruksion rrugë, fshati Drenovicë, Bashkia Dimal”.....	14346

**VENDIM****Nr. 453, datë 10.7.2024****PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË ROSKOVEC, TË PASURIVE ME NUMËR 213/1-ND1, 213/1-ND2 DHE 213/1-ND3, ZONA KADASTRALE 3805, NJËSIA ADMINISTRATIVE KURJAN, SI DHE PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 770, DATË 24.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Roskovec të pasurive me numër 213/1-ND1, 213/1-ND2 dhe

213/1-ND3, zona kadastrale 3805, Njësia Administrative Kurjan, sipas formularit dhe planeve të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik.

2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohen listës së inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 770, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec, të qarkut të Fierit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Bashkia Roskovec dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku**



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET	DATE 24.04.2024	QELLIMI (Inventarizim)
VENDNDODHJA VLOSH		
BASHKIA ROSKOVEC	DVASHK / ZVASHK FIER	ZONA KADASTRALE 3805 NUMRI PASURISE 213/1-ND1 INDEKSI HARTES K-34-112-(233-D)
TE DHENAT E PASURISE	SIP.PASURISE: 770 m2	SIP. GJURMES SE NDERIMIT: 770 m2 NUMRI I KATEVE 1 NUMRI I PEMEVE ----
LLOJI PASURISE: NDERTES		
X- 480409.3	KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPETARE	X- 480898.2
Y- 4506473.7		Y- 4506473.7



X- 480409.3
Y- 4506119.9

SH : 1:2500

X- 480898.2
Y- 4506119.9

Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi kufirit	Kufitari	ID / Nipt	Shenime te realizuesit
1	Veri		Rruge	132		
2	Lindje		Are+truall	7/23		
3	Juge		Toke are	7/12-15		
4	Perendim		Toke are	7/10-11		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI : ANTONIN MINO

LICENSA : NR. T 0580/1 DATE 30.03.2017

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE T

Kode per teknologjine e matjeve : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Stacion Total ; D - Matje Distancash

PERCAKTIMI KUFIRIT HK

Kode per percaktimin e kufirit : P - Perfaqesuesi i pronave ; K - Kufitare te Gjithe ; Kp - Kufitare te Pjeserisht

PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI Mojinda

MBIEMRI Burcu

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimin e kufirit : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Stacion Total ; D - Matje Distancash ; P - Perfaqesuesi i pronave ; K - Kufitare te Gjithe ; Kp - Kufitare te Pjeserisht PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : SHTET

DATE 24.04.2024

QELLIMI (Inventarizim)

VENDNDODHJA VLOSH

BASHKIA ROSKOVEC

DVASHK / ZVASHK FIER

ZONA KADASTRALE 3805

NUMRI PASURISE 213/1-ND2

INDEKSI HARTES K-34-112-(233-D)

TE DHENAT E PASURISE

SIP.PASURISE: 770 m2

SIP. GJURMES SE NDERTIMIT: 770 m2

NUMRI I KATEVE 1

NUMRI I PEMEVE

LLOJI PASURISE: NDERTES


X- 480409.3

Y- 4506473.7

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPETARE

X- 480898.2

Y- 4506473.7



Pasuria nr.213/1-ND2- 770 m2 Ndertes

X- 480409.3

Y- 4506119.9

SH : 1:2500

X- 480898.2

Y- 4506119.9

Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi kufirit	Kufitari	ID / Nipt	Shenime te realizuesit
1	Veri		Rruge	132		
2	Lindje		Are+truall	7/23		
3	Juge		Toke are	7/12-15		
...	Perendim		Toke are	7/10-11		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI : ANTONIN MINO

LICENSA : NR. T 0580/1 DATE 30.03.2017

NENSHKRIMI / VULA

TEL: 0682340611
ANTONIN MINO

TEKNOLOGJIA E MATJEVE T

Kode per teknologjine e matjeve : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Stacion Total ; D - Matje Distancash

PERCAKTIMI KUFIRIT HK

Kode per percaktimin e kufirit : P - Perfaqesuesi i pronave ; K - Kufitare te Gjithe ; Kp - Kufitare Pjeserisht

PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBELBARDHENIET ME KUFITARET

EMRI


MBEMRI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimin e kufirit : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Stacion Total ; D - Matje Distancash ; P - Perfaqesuesi i pronave ; K - Kufitare te Gjithe ; Kp - Kufitare Pjeserisht PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : SHTET	DATE 24.04.2024	QELLIMI (Inventarizim)
VENDNDODHJA VLOSH BASHKIA ROSKOVEC DVASHK / ZVASHK FIER ZONA KADASTRALE 3805 NUMRI PASURISE 213/1-ND3 INDEKSI HARTES K-34-112-(233-D) TE DHENAT E PASURISE SIP.PASURISE: 770 m2 SIP. GJURMES SE NDERTIMIT: 770 m2 NUMRI I KATEVE 1 NUMRI I PEMEVE ---- LLOJI PASURISE: NDERTES X- 480409.3 Y- 4506473.7		
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPETARE		
		X- 480898.2 Y- 4506473.7



Pasuria nr.213/1-ND3- 770 m2 Ndertes

 X- 480409.3
 Y- 4506119.9

SH : 1:2500

 X- 480898.2
 Y- 4506119.9

Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi kufirit	Kufitari	ID / Nipt	Shenime te realizuesit
1	Veri		Rruge	132		
2	Lindje		Are+truall	7/23		
3	Juge		Token are	7/12-15		
...	Perendim		Token are	7/10-11		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI : ANTONIN MINO

LICENSA : NR. T 0580/1 DATE 30.03.2017

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE T

Kode per teknologjine e matjeve : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Stacion Total ; D - Matje Distancash

PERCAKTIMI KUFIRIT HK

Kode per percaktimin e kufirit : P - Perfaqesuesi i pronave ; K - Kufitare te Gjithe ; Kp - Kufitare Pjeserisht

PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale

PRONARI/BASHKIPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI

MBIEMRI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimin e kufirit : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Stacion Total ; D - Matje Distancash ; P - Perfaqesuesi i pronave ; K - Kufitare te Gjithe ; Kp - Kufitare Pjeserisht PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia: ROSKOVEC, Njësia Administrative Kurjan Fusha e perdorimit te Prones: Zhvillim Ekonomik Identifikoi: Eneida Hoxha, Eldison Kocaqi (Topograf) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Supervizoi: Agur Shabanaj (I.M.M. Tokës) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Aprovoi: Majlinda Buri (Kryetari i Bashkisë) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)										
A				B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	3805 233-D	213/1-ND1	Ndertes	Ish magazine grumbullimi Fshati Vlosh		770	Zhvillim ekonomik (per grumbullimin dhe magazinimin e vajit te ullirit)	Bashkia Roskovec	Bashkia Roskovec	Ndertes ndodhet mbi truallin me numer pasurie 213/1 transferuar ne pronesi te Bashkise Roskovec me VKM nr.27 date 27.01.2023
2	3805 233-D	213/1-ND2	Ndertes	Ish magazine grumbullimi Fshati Vlosh		770	Zhvillim ekonomik (per grumbullimin dhe magazinimin e vajit te ullirit)	Bashkia Roskovec	Bashkia Roskovec	Ndertes ndodhet mbi truallin me numer pasurie 213/1 transferuar ne pronesi te Bashkise Roskovec me VKM nr.27 date 27.01.2023
3	3805 233-D	213/1-ND3	Ndertes	Ish magazine grumbullimi Fshati Vlosh		770	Zhvillim ekonomik (per grumbullimin dhe magazinimin e vajit te ullirit)	Bashkia Roskovec	Bashkia Roskovec	Ndertes ndodhet mbi truallin me numer pasurie 213/1 transferuar ne pronesi te Bashkise Roskovec me VKM nr.27 date 27.01.2023

**VENDIM****Nr. 454, datë 10.7.2024****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I KOPSHTIT
NR. 37”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtimi i Kopshtit nr. 37”, Bashkia Tiranë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 25 247 313 (njëzet e pesë milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e trembëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 25 247 313 (njëzet e pesë milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e trembëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



TABELA E SHPRONËSIMIT TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHET, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I KOPSHTIT NR. 37”, BASHKIA TIRANË

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë, etj.)
													“TRUALL”			“NDËRTESE”				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qytetit	Zonë kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	Volumi	Faqja	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	
	A	B	C	D	E	F	G	H	J	I	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T
1	Alfred	Robert	Gjata	Tiranë	8380	3/144	Truall	496.00	496.00	0.00	20	19	377.00	66,969	25,247,313	0.00	0.00	0.00	25,247,313	Konfirmuar nga ASHK Shënim: Seksioni D- i kartelës së pasurisë: Kontratë për vendosje e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, sipas vlerave të kredisë UNION BANK, nr. 23988, datë 20.11.2023
VLERA TOTALE																			25,247,313	

**VENDIM****Nr. 455, datë 10.7.2024****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “REHABILITIMI URBAN I
NJË PJESE TË BLOKUT NR. 3, NË
QENDËR TË QYTETIT TË ROSKOVECIT
(FAZA 1)”, BASHKIA ROSKOVEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr. 3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)”, Bashkia Roskovec.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Roskovec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 9 431 003 (nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 431 003 (nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e tre) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruara në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Roskovec.

8. Bashkia Roskovec kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Roskovec.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Roskovec për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Roskovec, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Roskovec, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTT “REHABILITIMI URBAN I NJË PJESE TË BLOKUT NR. 3, NË QENDËR TË QYTETIT ROSKOVEC (FAZA 1)”, BASHKIA ROSKOVEC

Nr. rendor	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE SIPAS KARTELËS SË PASURISË										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m ²)	Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	Volumi	Faqe	ARË			TRUALL			VLERA TOTALE (lek)		
														Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)			
1	Eqerem Et'hem Hajrie Ilirjan Jolldiz Kujtim Mehdije Muharrem Pranvera Rubie Senije Umberto Xheladin Ymid		Risilia Resuli Shehu Kongoli Bedini Kryeziu Hoxha Resuli Kryeziu Risilia Resuli Resuli Kryeziu Resuli	Roskovec	3196	2/282	Truall	6900	0	6900	0	14	74				6900	494	3,408,600	3,408,600	Konfirmuar nga ASHK-ja	
2	Eqerem Et'hem Hajrie Ilirjan Jolldiz Kujtim Mehdije Muharrem Pranvera Rubie Senije Umberto Xheladin Ymid		Risilia Resuli Shehu Kongoli Bedini Kryeziu Hoxha Resuli Kryeziu Risilia Resuli Resuli Kryeziu Resuli	Roskovec	3196	2/283	Truall	9775	0	9755	0	14	75	0	269	-	9775	494	4,828,850	4,828,850	Konfirmuar nga ASHK-ja Seksioni D i kartelës së pasurisë: - Referenca nr. 2342, datë 22.7.2017: Me vendimin datë 31.5.2010 të Gjykatës Fier bëhet regjistrimi i padisë nr. 1230 prot., datë 19.5.2010.	
3	Servet	Dervish	Pirra	Roskovec	3196	352/13	arë	3687	3687	0	0	16	123	2675	269	719,575	0	494	0	719,575	Konfirmuar nga ASHK-ja	
4	Gezim	Servet	Pirra	Roskovec	3196	352/18	arë	2000	2000	0	0	16	121	1286	269	345,934	0	494	0	345,934	Konfirmuar nga ASHK-ja	
5	Fredi Zana Rudina Resmije Edlira Mira Xhuljeta	Asqeri Elmas Asqeri Asqeri Asqeri Asqeri	Dyle Dyle Mullaj Rrapushaj Haxhij Xhaxhaj Dyle	Roskovec	3196	349/10	arë	6600	6600	0	0	23	121	476	269	128044	0	494	0	128,044	Konfirmuar nga ASHK-ja Seksioni D i kartelës së pasurisë: - Referenca nr. 2817, datë 30.12.2013: Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm.	
VLERA TOTALE																1.193.553				8.237.450	9.431.003	



VENDIM

Nr. 459, datë 10.7.2024

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 101, DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KOHËN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË POLICINË E SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 76–108, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun I, të vendimit nr. 101, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kohën e punës dhe pushimit në Policinë e Shtetit”, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 12 shtohen pikat 12/1 e 12/2, me këtë përmbajtje:

“12/1. Aktivizimi i punonjësve të policisë në punë/shërbim me zgjatje të kohës normale të punës/shërbimit, 4 (katër) orë për çdo turn/shërbim, bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe realizohet gjatë sezonit turistik veror, për periudhën nga data 16 qershor deri në datën 15 shtator.

12/2. Zgjatja e kohës normale të punës/shërbimit, 4 (katër) orë për çdo turn/shërbim, gjatë sezonit turistik veror, për periudhën nga data 16 qershor deri në datën 15 shtator, kompensohet me pagë dhe pagesa kryhet bashkë me pagën mujore të muajit kur është kryer shërbimi.”.

b) Në pikën 13, pas fjalëve “... mbi kohën normale të punës ...” shtohen “... dhe zgjatjes së kohës normale të punës/shërbimit ...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit për programin buxhetor “Policia e Shtetit”.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 460, datë 10.7.2024

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT, ORGANIZIMIT, KLASIFIKIMIT DHE TARIFAVE TË REGJISTRIMIT TË VEPRAVE TË TË DREJTAVE TË AUTORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e procedurës së regjistrimit të veprave të së drejtës së autorit, sipas klasifikimit dhe organizimit të tyre, si dhe të tarifave të regjistrimit, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar.

2. Regjistrimi i së drejtës së autorit është vullnetar dhe u referohet vetëm të drejtave të autorit.

3. Regjistrimi i së drejtës së autorit kryhet nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit në ministrinë përgjegjëse për të drejtat e autorit.

4. Aplikimi për regjistrimin e së drejtës së autorit kryhet *on-line* në portalin “*e-Albania*”, në shërbimin elektronik “Regjistrimi i së drejtës së autorit”.

5. Aplikimi kryhet nga autori i veprës, trashëgimtari ligjor, përfaqësuesi i autorizuar prej autorit/bashkautorit ose agjencia e administrimit kolektiv.

6. Aplikimi për regjistrimin e të drejtave të autorit shoqërohet me dokumentacionin e domosdoshëm, si më poshtë vijon:

a) mandatpagesën, e cila është e vlefshme vetëm për një aplikim, nëpërmjet të cilit regjistrohet një numër i caktuar veprash, sipas tarifave të parashikuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) kopjen e veprës *on-line* në portalin “*e-Albania*” ose fizikisht, në formë të shkruar ose CD, në protokollin e ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit;

c) dokumentin autorizues të përfaqësimit, në rast se kërkesa kryhet nga një përfaqësues;



ç) dokumentin e dëshmisë së trashëgimisë, në rast se kërkesa kryhet nga trashëgimtari/ët ligjor/ë.

7. Procedura e regjistrimit në Drejtorinë për të Drejtën e Autorit zgjat në një afat maksimal prej 30 (tridhjetë) ditësh. Konkretisht, kjo procedurë përfshin:

a) aplikimin e depozitimit të dokumenteve shoqëruese në portalin “e-Albania”. Përjashtimisht, vetëm dokumentet, të cilat nuk mund të ngarkohen në format elektronik, i dërgohen institucionit në format shkresor (*hard copy*) brenda 5 (pesë) ditëve nga data e aplikimit;

b) korrigjimin e pasaktësive nga aplikanti, brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa e Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, në rastet kur aplikimi nuk është paraqitur, në përputhje me pikën 6, të këtij vendimi. Në rast të mosplotësimit të pasaktësive brenda këtij afati, aplikimi refuzohet;

c) shqyrtimin e kërkesës në raport me parashikimet e ligjit për të drejtat e autorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Në rast se vepra që kërkohet të regjistrohet nuk është objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, aplikimi refuzohet në mënyrë të arsyetuar;

ç) regjistrimin e veprës dhe pajisjen me certifikatë ose refuzimin, sipas shkronjës “c” të kësaj pike, brenda 5 (pesë) ditëve.

8. Në rast të plotësimit të kushteve ligjore për regjistrimin e së drejtës së autorit, Drejtoria për të Drejtën e Autorit lëshon certifikatën e regjistrimit të së drejtës së autorit.

9. Certifikata e regjistrimit të së drejtës së autorit merret nëpërmjet portalit “e-Albania” me nënshkrim ose vulë elektronike.

10. Drejtoria për të Drejtën e Autorit përditëson të dhënat e regjistrimit të së drejtës së autorit në bazën e të dhënave shtetërore “Regjistri i të dhënave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to”.

11. Data e regjistrimit të të drejtave të autorit është data e aplikimit të kryer në mënyrë të rregullt *on-line* në portalin “e-Albania”.

12. Organizimi dhe klasifikimi i veprave të së drejtës së autorit do të kryhet sipas vendimit nr. 651, datë 22.11.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri i të dhënave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to” dhe përcaktimin e elementeve të regjistrimit të të dhënave të hapura për publikun, dokumentar dhe elektronik”.

13. Format i dhe elementet përbërëse të certifikatës “Regjistrimi i së drejtës së autorit” përcaktohen me urdhrë të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit.

14. Regjistrimi dhe certifikimi nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit kanë efekt ligjor derisa me vendim gjyqësor të provohet e kundërta.

15. Vendimi nr. 34, datë 18.1.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e regjistrimit, të organizimit dhe klasifikimit të veprave të të drejtave të autorit”, shfuqizohet.

16. Ngarkohet ministria e përgjegjëse për të drejtën e autorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKSI 1

Nr.	Shërbimi	Tarifa
1	Një aplikim për regjistrimin e veprave të së drejtës së autorit, që janë objekt mbrojtjeje sipas ligjit nr. 35/2016, për krijimin origjinal nga autori/autorët së bashku me lëshimin e certifikatës përkatëse: a) Deri në 20 vepra; b) Nga 21 deri në 50 vepra; c) Nga 51 deri në 100 vepra; ç) Më shumë se 100 vepra.	2 000 lekë 3 000 lekë 4 000 lekë 5 000 lekë
2	Modifikimi i të dhënave, publikimi i modifikimit të dhënave të këtyre ndryshimeve ose korrigjimi i të dhënave, si dhe publikimi i korrigjimit të të dhënave në regjistrin e të dhënave të të drejtave të autorit	2 000 lekë

**KËRKESË****Nr. 825/6, datë 9.7.2024****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Rikonstruksion rruge, fshati Drenovicë, Bashkia Dimal’.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Dimal.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në VKM- në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për pasuritë e llojit “ndërtesë”, bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së

masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit ‘ndërtesë’”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Dimal, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **1,750,494 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION RRUGE, FSHATI DRENOVICË”

NR.	P R O N A R I			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM										SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)	SEKSIONI D	SEKSIONI E
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Arë" (m2)	"Truall" (m2)	"Ndërtesë" (m2)	Volumi	Faqe	"ARË"			"TRUALL"			"NDËRTESE"			VLERA TOTALE (lekë)			
														Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)				
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	Y	Z		
1	Xhezmi	Ali	Sulovari	Kutalli	2349	45/7	Truall	84		84	84	8	44			0	84	203	17,052	84		1,733,442	1,750,494			
	SHUMA TOTALE																		17,052			1,733,442	1,750,494			

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 64 lekë